



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit

Ref. nr. 4997

Prishtinë, 15.11.2024

Në bazë të nenit 56 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, vendimit nr. 4/431 dt. 11.11.2024 të Senatit, si dhe nenit 41 dhe 42 të Ligjit nr 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Këshilli i Fakultetit përmes procedurës qarkulluese më 15.11.2024, mori këtë

V E N D I M

Për vlerësim intermediar I dhe II të studentëve

I – Aprovohet propozimi i Dekanit të Fakultetit, në përputhje me vendimin e Senatit nr. 4/531, të datës 11.11.2024, për vlerësim intermediar I dhe II të studentëve, sipas pikës II të vendimit të cekur.

II – Studentët kanë të drejtë të paraqesin tri lëndë, për hyrje dhe vlerësim intermediar I, gjatë afatit për paraqitje të lëndëve dhe vlerësimi do të realizohet përmes modulit për vlerësim të studentëve me se largu deri me 20 dhjetor 2024. Paraqitja nga 15.11.2024 deri me 06.12.2024, vlerësimi me 7-8 dhe 14-15.dhjetor 2024.

III – Studentët kanë të drejtë të paraqesin tri lëndë, për hyrje dhe vlerësim intermediar II, gjatë afatit për paraqitje të lëndëve, vlerësimi do të realizohet përmes modulit për vlerësim të studentëve në SEMS, me se largu deri me 10 maj 2025. Paraqitja nga 14.04.2025 deri me 25.04.2024, vlerësimi me 26-27 prill dhe 3-4.maj.2025.

IV – Publikimi i datës dhe orarit të vlerësimit të publikohet nga departamentet përkatëse, në respektim dhe brenda afateve kohore të cekura në pikë II dhe III të këtij vendim.

V - Studentët të cilët nuk i kanë kryer obligimet e pagesës së semestrit dimëror, të cilët nuk janë aktiv, nuk kanë të drejtë të paraqitje dhe vlerësimi si dhe nuk mund të kryejnë shërbime për vitin akademik 2024/2025.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të FSHMN-së;
- Shefave të Departamenteve;
- Zyrës për studime bachelor dhe master.

Dekani i Fakultetit

Prof. asoc. Kajtaz Bllaca

